



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 28
14.07.2017

NR. VENDIMI 24
21.07.2017

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë nga:

Kryesuese: Irena XXXXX

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Andina Kaja**, në Tiranë, sot me datë 21.07.2017, mori në shqyrtim kërkesën me palë:

KËRKUES: **A. L.** , i biri i A. dhe i G. , i dtl xx.xx.xxxx, lindur Elbasan, banues ne Elbasan, me arsim te mesëm, pa profesion, me gjëndje civile beqar, me shtetësi shqiptare, me gjendje gjyqësore, i padënuar më parë, i përfaqësuar në gjykim me deklaram në seancë gjyqësore nga av. P. S. , me licensën Nr.xx, Nipti X XXXXXX X, anëtar i dhomës së avokatisë Tiranë.

PERSON I TRETË: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga prokurore Pranvera Pustina.

OBJEKTI: Revokim i masës së sekuestrimit mbi pasurinë, në emër të shtetasit A. L. , të vendosur me vendimin Nr.14 datë 28.07.2016, të Gjykatës Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 12 i ligjit nr.1092 datë 10192 datë 03.12.2019 “Për ndalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, administroi provat, dëgjoi në diskutimin përfundimtar përfaqësuesin e kërkuarit si dhe kërkuarin A. L. , i cili, kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit, pasi dëgjoi prokuroren, e cila, e la në vlerësim të gjykatës kërkesën e paraqitur nga avokati.

VËREN:

Në datën 14.07.2017, kërkuari A. L. , ka paraqitur kërkesë para gjykatës, me objekt; Revokim i sekuestrimit të pasurisë në emër të shtetasit

A. L. ,të vendosur me vendimin Nr.14 datë 28.07.2016, të Gjykatës Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me bazë ligjore neni 12 i ligjit nr.1092 datë 10192 datë 03.12.2019 “Për ndalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Me vendimin Nr.14, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda, Tiranë, duke vendosur masën e sekuestros, në bazë të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar mbi pasurinë;

- Pasuria e llojit truall prej 120 m2, ndodhur në ZK XXXX, nr. pasurie X/XXX, vol. XX, faqa XXX, vijon nga vol. XX faqa XXX, ndodhur në rruga “xxxxx xxxxxxxx”, Tiranë, në emër të shtetasit A. L. .
- Pasuri të llojit truall 340 m2 nga e cila ndërtesë 100 m2, ndodhur në rruga “xxxx xxxxxx”, ndodhur në ZK XXXX, nr. pasurie X/XXX, vol. XX faqa XXX, vol. XX faqa XXX, rregjistruar më datë 08.06.2006, së bashku me shtesën e ndërtimit sipas proceverbalit të vetdeklarimit të shtetasit A. L. .
- Pasuria me nr. X/XX+X-X e llojit “Njësi”, me sipërfaqe 46 m2, e rregjistruar në vol. XX, faqe XX, e cila ndodhet në Lagja “XXXXXX i XXXXXX”, ZK XXXX, Elbasan, në emër të shtetasit A. L. .
- Pasuria me nr. X/XX+X-X e llojit “Njësi”, me sipërfaqe 97.67 m2, e rregjistruar në vol. XX, faqe XX, ZK XXXX, e cila ndodhet në Lagja “XXXXX i XXXXXXXX”, ZK XXXX, Elbasan dhe figuron në pronësi të shtetasit S. A. D. (L.).
- Shoqëria XXXX XXXX SHPK me nr NUIS XXXXXXXX regjistruar më datë 30.01.2001 me zyrë qendrore në Elbasan, me ortak të vetëm dhe administrator aktual A. O. .
- Shoqëria XXXX XXXXX SHPK me nr. NUIS X XXXXXXX X, regjistruar më datë 26.12.2006, me zyrë qendrore në Elbasan, me ortak të vetëm dhe administrator aktual A. O. .

Nga, ana e Prokurorisë për Krime të Rënda, pasi janë kryer veprimet që ajo ka çmuar të nevojshme për hetimin pasuror, me datë **20.06.2017** është vendosur pushimi i procedimit pasuror, Nr.19 te vitit 2011 per pasurine ne zoterim te shtetasit A. L. me arsyetimin që, nuk plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara nga ligji Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, duke referuar si bazë ligjore nenin 3,11 dhe 24, e këtij ligji.

Pas komunikimit të këtij vendimi nga ana e prokurorisë, kërkuesi A. L. , me datë 14.07.2017, ka paraqitur kërkesë para gjykatës, me objekt heqjen e sekuestros mbi pasurinë më sipër.

Kërkuesi, pretendoi se nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda, pasi janë kryer veprimet që ajo ka çmuar të nevojshme për hetimin pasuror, me datë 20.06.2017 është vendosur pushimi i procedimit pasuror, me arsyetimin që, nuk plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara nga ligji Nr. 10 192, datë 3.12.2009. Në këto rrethana kur Prokuroria ka pushuar hetimin pasuror është shuar edhe masa e sekuestros vendosur me vendimin Nr.14, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë. Nga ana tjetër, prokurori parashitroi para gjykatës se prokuroria ka marrë vendim për pushimin e procedimit pasuror në datën 20.06.2017, për procedimin pasuror Nr.19 te vitit 2011 për pasurinë në zoterim te shtetasit A. L. . Me vendimin e po kësaj gjykate Nr.14 date 28.07.2016 është vendosur sekuestro mbi pasurinë e këtij shtetasi në kuadër të procedimit pasuror. Kjo sekuestro është zgjatur me nje vendim te dyte dhe më pas nga prokuroria nuk është kërkuar zgjatja e mëtejshme e kësaj sekuestroje. Në këtë kuptim, jo vetëm bazuar ne vendimin e pushimit por edhe më e rëndësishme, bazuar edhe në afatin e sekuestros, ajo nuk ekziston për shkak të mbarimit të afatit por edhe bazuar ne vendimin e pushimit.

Vlerësimi i gjykatës

Në lidhje me zgjidhjen e Çështjes gjykata i referohet nenit 12 të ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009.

Neni 12

Procedura e sekuestrimit

- 1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata, me pjesëmarrjen e prokurorit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij.*
- 2. Vendimi për masën e sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij. Masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj.*
- 3. Në rastin e verifikimeve komplekse, me kërkesë të prokurorit, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit për periudha tremujore, por jo më shumë se një vit nga data e mbarimit të afatit të masës së sekuestrimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në një gjykatë të një niveli më të lartë.*
- 4. Kur masa e sekuestrimit caktohet ndaj pasurive të paluajtshme ose pasurive të regjistruara në regjistra publikë, administratori i emëruar bën menjëherë njoftimin e kësaj mase në zyrat, pranë të cilave mbahen këta regjistra.*
- 5. Prokurori, jo më vonë se 5 ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit, të parashikuar në pikën 2 ose 3 të këtij neni, mund të paraqesë kërkesë për konfiskimin, e pasurisë ose zgjatjen e afatit të masës së sekuestros. Në rast të kërkesës për konfiskim, masa e sekuestrimit vazhdon deri në përfundimin e gjykimit për konfiskimin e pasurisë.***
- 6. Mosparaqitja e kërkesës, sipas pikës 5 të këtij neni, passjell shuarjen e masës së sekuestrimit. Megjithatë, shuarja e sekuestrimit nuk*

pengon paraqitjen dhe pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë.

Gjykata, çmon se, baza ligjore që duhet të zbatohet, për zgjidhjen e çështjes konkrete është, neni 12 i ligjit Nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, para ndryshimeve të bëra këtij ligji me ligjin nr. 70, të vitit 2017, pasi në pikën 1 të Dispozitës kalimtare, parashikohet që, **ndryshimet e bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017, zbatohen për kërkesat e marrjes së masave parandaluese të paraqitura nga prokurori në gjykatën kompetente, pas hyrjes në fuqi të tij.**

Referuar faktit që ndryshimet e ligjit Nr.70, të vitit 2017, kanë hyrë në fuqi me datë 23.6.2017, ndërkohë që, kërkesa nga ana e prokurorit për marrjen e masës parandaluese ndaj kërkuarit A. L. , në rastin konkret ka qenë masa e sekuestrimit të pasurisë, është paraqitur nga prokurori, me datë **27.07.2016**, pra, para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017, në ligjin e posaçëm, nr.10192, datë 03.12.2009, ndaj neni 12 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017, nuk mund të gjejë zbatim në këtë rast.

Referuar përmbajtjes së nenit 12 i ligjit Nr. 10192, datë 03.12.2009, si dhe në qëllimit të këtij ligji, para ndryshimeve të bëra këtij ligji me ligjin Nr. 70 të vitit 2017, rezulton që, gjykata nuk ka rol aktiv, duke ia besuar organit të akuzës mbrojtjen e interesit publik, në kushtet kur, ky i fundit, për shkaqet që ka çmuar të arsyeshme, ka vendosur pushimin e procedimit pasuror, në ngarkim të kërkuarit, me arsyetimin se, nuk përmbushen kërkesat e ligjit të veçnatë Nr. 10192, datë 03.12.2009, për konfiskimin e pasurisë së tyre, gjykata, nuk mund të vlerësojë këtë vendimmarrje të akuzës dhe është e detyruar që, të pranojë kërkesën e kërkuarve për heqjen e masës së sekuestrimit, pasi, me marrjen e vendimit të pushimit të procedimit pasuror nga organi i akuzës, mungon objekti dhe shkak i ligjor se pse, kjo pasuri të qëndrojë e sekuestruar.

Jo vetëm bazuar në vendimin e pushimit, por edhe më e rëndësishme bazuar edhe në faktin se prokurori nuk paraqiti kërkesë **5 ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit, as për zgjatje të afatit të sekuestrimit e as për konfiskim të pasurisë, mosparaqitja e kërkesës, sipas pikës 5 të nenit 12, passjell shuarjen e masës së sekuestrimit.**

Në kushtet që ligjvënësi, i ka besuar mbrojtjen e interesit publik, organit të akuzës akuzës, i cili ka vlerësuar dhe vendosur që, këto pasuri nuk mund të konfiskohen dhe në kushtet kur, ligji që ishte në fuqi kur është kërkuar kjo masë parandaluese, si dhe kur është marrë vendimi për pushimin e procedimit pasuror, nuk i jep të drejtë gjykatës për të vlerësuar këtë vendimmarrje të organit të akuzës, e cila, është ndryshuar më vonë, me ndryshimet e bëra në ligj, me ligjin nr. 70, të vitit 2017, gjykata, në këtë rast, është e detyruar që të disponojë me pranimin e kërkesës së kërkuarit, e

revokimin e sekuestros.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenin 12, të ligjit Nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, para ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 70, të vitit 2017, nenit .

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit A. L. .
2. Heqjen e masës së sekuestros vendosur me vendimin Nr.14 datë 28.07.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë mbi pasurinë, në emër të shtetasit A. L. dhe personave të lidhur me të.
3. Ngarkohet Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave, Tiranë, si dhe Zyra përkatëse e Përmbarimit, për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vndimi.

U shpall, në Tiranë, sot me datë 21.07.2017.

SEKRETARE

ANDINA KAJA

IRENA XXXXX

GJYQTARE

